



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 115, Datë 21.04.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 262, DATË 21.10.2025  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “VIVID POWER” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 41/4 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 15.01.2026, ka licencuar shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: “Me fillimin e operimit, shoqëria të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike”, ndërsa në pikën 4 është përcaktuar se: Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.

**2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria**

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 41/2 prot., datë 22.01.2026, duke i sjellë në vëmendje edhe detyrimin për plotësimin e kushtit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41/3 prot., datë 07.04.2026, shoqëria ka depozituar në ERE marrëveshjen e shërbimit për ofrimin e shërbimeve IT dhe stafit teknik-administrativ.

**3. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 262/2025 dhe me plotësimin e këtij kushti rezulton se nuk gjen më zbatim sa përcaktuar në pikën 4 të vendimit, ndaj vlerësohet edhe shfuqizimi i kësaj pike.

#### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi kompetent.
- Duke qenë se është përmbushur kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 262/2025, të ndryshuar, vlerësohet se kjo pikë duhet të shfuqizohet, si dhe pika 4 e këtij vendimi, e cila nuk gjen më zbatim, duhet gjithashtu të shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, si vijon:
  - a) *Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, shfuqizohet.*
  - b) *Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, shfuqizohet.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k., “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**